



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 152 Akti

Nr. 104 Vendimi

Tiranë, më 7.2.2019

V E N D I M

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të trupit gjykues të përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Anëtar
Valbona Sanxhaktari	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, më datë 6 shkurt 2019, ora 9:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Eriol Roshi**, gjyqtar/kryetar, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/ b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Eriol Roshi, në seancë dëgjimore publike, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësinë e saj,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Eriol Roshi është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë. Në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*. Bazuar në nenin 4, pika 4, dhe në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (këtu e në vijim referuar si “Komisioni”) ka hedhur shortin më datë 15.5.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4.

2. Me vendimin nr. 1, datë 24.5.2018 të trupit gjykues, është caktuar kryesuese znj. Genta Tafa (Bungo), është deklaruar mospasja e konfliktit të interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues, si dhe fillimi i hetimi administrativ kryesisht. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është z. Theo Jacobs.

3. Nga relatori u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga:

- a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e më poshtë referuar si “ILDKPKI”), sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016;
- b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e më poshtë referuar si “DSIK”), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe
- c) Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (këtu e më poshtë referuar si “KLD”), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga neni 14, pika 5, i ligjit nr. 84/2016.

5. Subjekti i rivlerësimit u njoftua për përbërjen e trupit gjykues më datë 13.9.2018.

6. Më datë 28.1.2019, trupi gjykues, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatori i çështjes, vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit z. Eriol Roshi, bazuar në të tre kriteret e vlerësimit: kriterin e vlerësimit të pasurisë, kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit dhe ta ftojë atë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, paraqitjen e shpjegimeve dhe provave për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si edhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

7. Subjekti i rivlerësimit e ushtroi të drejtën për t’u njohur me dosjen dhe paraqiti brenda afatit të caktuar nga Komisioni, shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit.

8. Komisioni ftoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, e cila u zhvillua më datë 6.2.2019, ora 9:00, në Pallatin e Koncerteve.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 6.2.2019, ora 9:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

10. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë, ai dha shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin e tij në detyrë.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

11. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

12. Komisioni ka kryer procesin e rivlerësimit për z. Eriol Roshi mbi tre kriteret vlerësimit të parashikuara në nenin 4, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, (a) vlerësimin e pasurisë, (b) kontrollin e figurës dhe (c) vlerësimin e aftësive profesionale.

13. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”;
- b) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga Inspektorati i Këshilli të Lartë të Drejtësisë, së bashku me materialin shoqërues;
- d) Provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) Deklarimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- ç) Denoncimet nga publiku;
- d) Shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, si edhe provat e paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

14. Subjekti i deklaramit, z. Eriol Roshi, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të nenit 33¹ të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

14.1 Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 33/5/a të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky institucion në raportin e tij ka konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

¹Procedura e vlerësimit të pasurisë 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaratimet e pasurive zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Kodin e Procedurave Administrative.

15. Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017 dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.²

16. Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Eriol Roshi, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklaram të rremë, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen.

17. Pas hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit rezulton se ka në pronësi pasuritë si vijon:

18. Apartament banimi me sipërfaqe 110 m², përfutur me kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 13.5.2015, dhe kontratë shitje nr. ***, datë 22.7.2016, në vlerën prej 7.920.000 lekë. Kontrata e shitjes rezultoi e paregjistruar në ZVRPP Tiranë, në momentin e deklaramit.

19. Burimi i krijimit sipas deklaramit “Vetting”:

- a. Kredi bankare, në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT), në shumën 6.336.000 lekë.
- b. Pjesë e mbetur e pashlyer e çmimit të apartamentit prej 1.584.000 lekë, paguar nga kursimet e subjektit të rivlerësimit, krijuar për shkak të kontratës së shitjes nr. ***, dt. 2.11.2012, kundrejt shpërblimit prej 55.500 euro, nga të cilat 18.500 euro pjesa e subjektit të rivlerësimit.

Hetimi i Kryer nga Komisioni³

20. Subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshorten e tij kanë porositur një apartament me sipërfaqe 110 m², përfshirë dhe sipërfaqen e përbashkët, me kontratë sipërmarrje - pronetim apartamenti nr. ***, datë 13.5.2015, me çmimin total prej 7.920.000 lekë.

21. Shuma prej 6,890,400 lekë, do të paguhej pas nënshkrimit të kontratës dhe diferenca prej 1,029,600 lekë do të paguhet në momentin e hipotekimit. Në kontratë përcaktohet se pagesa do të bëhet nëpërmjet sistemit bankar në llogarinë e shitësit, në BKT.

22. Më datë 22.7.2016 është lidhur kontrata e shitjes nr. ***, për blerjen e apartamentit me nr. ***, zona kadastrale ***, volum ***, faqe ***, në rrugën “*****” Tiranë, shk. ***, ap. ***, kati ***, sipërfaqe totale 96 m², në shumën 6,912,000 lekë. Bazuar në nenin 2.2 të kësaj kontrate rezulton se çmimi është shlyer totalisht nga blerësi tek shitësi, sipas kontratës nr. ***, dt. 13.5.2015.

23. Për sa më sipër rezultoi një mospërputhje midis çmimit të deklaram në kontratën e shitjes dhe çmimit të deklaram në kontratën e sipërmarrjes, e cila vjen si pasojë e

²Vendimi nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi.”

³ Shkresë nr. *** prot., datë 5.11.2018 drejtuar bankave dhe institucioneve financiare; Kthim përgjigje BKT-ja, shkresa nr. *** prot., datë 22.11.2018; Shkresë nr. *** prot., datë 5.11.2018 drejtuar ZQRPP; Kthim përgjigje ZVRPP-ja Tiranë, shkresa nr. *** prot., datë 19.11.2018; Shkresë nr. *** prot., datë 5.11.2018 drejtuar OSHEE-së; Kthim përgjigje OSHEE-ja, shkresa nr. *** prot., datë 16.11.2018; Shkresë nr. *** prot., datë 5.11.2018 drejtuar UKT-së. Kthim përgjigje UKT-ja, shkresa nr. *** prot., datë 16.11.2018.

deklarimit të sipërfaqes 96 m² (96 m² x 72000 lekë = 6,912,000 lekë) në kontratën e shitblerjes.

24. Në lidhje me këtë konstatim subjekti i rivlerësimit sqaron se: *“Mes dy shumave të ndryshme në kontratën e sipërmarrjes dhe atë të shitjes nuk ka mospërputhje, porse në kontratën e shitjes sipërfaqja e apartamentit është 96 m² dhe në të nuk përfshihen sipërfaqet e përbashkëta, të cilat janë në bashkëpronësi të detyrueshme.”*

25. Është e paqartë se cilat janë arsyet e mosregjistrimit të kësaj kontrate në ZVRPP, nisur edhe nga fakti se pas kalimit të afatit 30-ditor subjekti i rivlerësimit ka penalitet në vlerë monetare për mosregjistrimin e saj.

26. Është pyetur subjekti i rivlerësimi për të dhënë arsye bindëse në lidhje me mosregjistrimin në ZVRPP të këtij apartamenti, duke marrë në konsideratë dhe penalitetet përkatëse.

26.1 Subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë konstatim sqaron se nuk ka asnjë arsye joligjore për mosregjistrimin e apartamentit: *“... unë si subjekti i rivlerësimit kam evidentuar se në kontratën e shitjes nr. ***, datë 22.7.2016, në nenin 2.1 është vendosur shuma 6,890,400 lekë, ndërkohë që bëhet fjalë për një gabim material, pasi sipërfaqja e apartamentit është 96 m² e shumëzuar me 72.000 lekë/m², shuma duhej të ishte 6,912,000 lekë, pra, një diferencë 21.600 lekë, pasaktësi që sjellë eventualisht dhe pamundësinë e regjistrimit.*

Pasaktësia në fjalë duhet të ndreqet në mënyrën që parashikon ligji dhe me nënshkrimin e përfaqësuesit ligjor të personit juridik që ka shitur apartamentin, veprim që jam i detyruar ta kryej në vijim... në vijim akti i ndrequr duhet të regjistrohet për efekt të zbatimit të detyrimeve kontraktuale dhe ligjore që rrjedhin nga ligji për regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Po ashtu kam disa pretendime në lidhje me shoqërinë e ndërtimit për kompensimin e një vlere të vogël nga çmimi i kontratës. Përdorimi i termit neglizhencë nënkupton pikërisht moskontrollin e dispozitave kontraktuale dhe veçanërisht të rezultatit të llogaritjes së bërë nga noteri, si dhe faktit që duhet të përmendja këtë pretendim për një kompensim të vogël me ndërtuesin.”

27. Nga OSHEE-ja dhe UKT-ja nuk rezulton kontratë e lidhur nga ana e subjektit të rivlerësimit për këtë apartament. Në lidhje me këto konstatime subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit sqaron se: *“Paguaj rregullisht detyrimet e energjisë elektrike, pavarësisht se kontrata është në emër të shoqërisë së ndërtimit; e njëjta situatë është edhe me librezën e konsumit të ujit me UKT-Tiranë.”*

28. Me kontratë kredie nr. *** datë 2.12.2015 subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshorten e tij kanë marrë hua shumën 6,336,000 lekë, për një afat 300 muaj. Nga kjo shumë, ka kaluar nëpërmjet bankës në llogarinë e shoqërisë së ndërtimit “***” sh.p.k., shuma prej 5,702,400 lekë.

29. Në nenin 4.1 të kontratës përcaktohet se banka ruan të drejtën e moskalimit të shumës **633,600 lekë** sipërmarrësit pa përfunduar procedurat e regjistrimit në ZVRPP. Për garantimin e kësaj kredie rezulton se dorëzanës është shoqëria e ndërtimit “***” sh.p.k., ndërsa apartamenti i porositur do të jetë kolateral i ardhshëm, i cili do të garantojë kredinë. Bazuar në nxjerrjen e llogarisë rezulton se shoqërisë së ndërtimit i ka kaluar shuma **5,702,400 lekë** në datën 24.12.2015, ndërsa shuma **633,600 lekë** është bllokuar deri në kalimin e titullit të pronësisë.

30. Bazuar në vërtetimin nr. ***, datë 24.01.2017 të BKT-së, rezulton se subjekti i rivlerësimit në datë 12.11.2015, ka depozituar shumën 11.461.65 euro (ekuivalenti në lekë në shumën **1.584.000**), e cila është transferuar tek pala shitëse sipas kontratës së sipërmarrjes.

31. Shuma prej 11.461.65 euro (ekuivalenti në lekë në shumën 1.584.000) paguar në datë 12.11.2015, ka patur si burim kursimet në shumën 18.500 euro, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklarinimin periodik vjetor.
32. Përfitimi i shumës prej 18.500 euro ka ardhur nga kursimet personale, krijuar për shkak të kontratës së kalimit të të drejtave me shpërblim në vitin 2012, nga ku subjekti i rivlerësimit ka përfitur shumën 18.500 euro.
33. Me kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 27.1.2006, subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e tij kanë porositur ndërtimin e një apartamenti me sipërfaqe 70.7 m² dhe ambiente të përbashkët me sipërfaqe 9.83 m², gjithsej 79.9 m², në shumën totale prej 49.000 euro, e cila do të paguhej me këste, sipas kontratës. Pagesat do të kryheshin *cash*.
34. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar të plotë praktikën e kontratës, tërhequr nga noteri, së bashku me mandatet e pagesës përkatësisht: mandatarkëtimi nr. ***, datë 27.1.2006, është paguar shuma 19.000 euro; mandatarkëtimi nr. ***, datë 30.1.2006, është paguar shuma 4.500 euro; mandatarkëtimi nr. ***, datë 29.08.2006, është paguar shuma 6.000 euro; mandatarkëtimi nr. ***, datë 22.12.2006, është paguar shuma 5.000 euro; mandatarkëtimi nr. ***, datë 16.3.2007, është paguar shuma 9.500 euro; mandatarkëtimi nr. ***, datë 30.10.2008, është paguar shuma 5.000 euro.
35. Rezultoi se të gjitha pagesat janë kryer nga i ati i subjektit të rivlerësimit z. I.R., përkundrejt mandatpagesave në shumën prej 49.000 euro.
36. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat e interesave private, shlyerjen e kësteve të kontratës, përkatësisht sipas përcaktimeve në kontratë.
37. Për sa më sipër rezultoi mospërputhje midis deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave private dhe mandatpagesave, nëpërmjet të cilave provohen pagesat e kësteve të kryera.
38. Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit sqaron se: *“Pagesat e të gjitha kësteve janë bërë nga babai nga të ardhurat e tij dhe jo nga unë, dhe prandaj mund të rezultojë kjo mospërputhje në vite, por në total ajo është e plotë.”*
39. I pyetur në lidhje me pozicionin juridik të subjektit të rivlerësimit në këtë kontratë sipërmarrjeje, ai deklaroi se ka qenë bashkëpronar, por nga ana e tij nuk është kontribuar në lidhje me pagesat e kryera për këtë apartament dhe se ka qenë dëshira e babait të tij që ai të kishte një shtëpi, pasi deri në ato momente nuk kishte patur.
40. Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave në shumën prej 49.000 euro, të cilat kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, nga të cilat pas shitjes, në vitin 2012, subjekti i rivlerësimit ka përfitur shumën prej 18.500 euro.
41. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se burim për pagesën e këtij apartamenti kanë qenë të ardhurat e siguruara nga ana e babait të tij, z. I. R.
42. Nga informacioni i mbledhur rezultoi se zoti R. ka filluar veprimtarinë tregtare që nga viti 1992, por është regjistruar si person fizik pranë organeve tatimore në vitin 1998. Ai ka ushtruar aktivitet tregtar shitje me pakicë në dyqane jo të specializuara me mbizotërim artikujsh ushqimorë, pije e duhan, në Rrugën e ***, Tiranë. Kjo veprimtari është mbyllur në datën 14.09.2012, sipas certifikatës së çregjistrimit, lëshuar nga QKB-ja.
43. Komisioni i kërkoi informacion Zyrës Rajonale të Tatim Taksave Tiranë, lidhur me fitimin pas tatimit, për subjektin tregtar I. R., e cila sqaron se⁴ me shkresat pararendëse ka dërguar në Komision informacion dhe të dhëna lidhur me qarkullimin vjetor të

⁴ Kthim përgjigje DRTT-ja, shkresa nr. *** prot., datë 25.1.2019.

subjektit tregtar (vit pas viti) dhe se nuk mund të llogaritet marzh fitimi, pasi tatimi për subjektet e biznesit të vogël llogaritet dhe derdhej në bazë të qarkullimit paraprak të deklaruar në fillim të vitit nga ana e subjektit.

44. Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit për të paraqitur në mënyrë të argumentuar fitimin neto të realizuar nga aktiviteti tregtar i ushtruar nga babai i tij. Ai paraqiti shpjegimet e tij nëpërmjet pyetësorëve të dërguar, si dhe në shpjegimet përfundimtare lidhur me rezultatet e hetimit, ku sqaroi se marzhi i fitimit i llogaritur i referohet natyrës së biznesit dhe se pjesa më e madhe e produkteve blihej nga individë të zonave përreth. Po ashtu vendi ku ushtrohej aktiviteti ka qenë i vetëm në këtë lloj dhe nuk ka patur konkurrencë, referuar artikujve që tregtoheshin.

Nr	Përshkrimi	Vlera
1.	Të ardhurat (qarkullimi në lekë)	24.016.660
2.	Kosto e mallrave të shitura Të ardhura x (1- marzhi fitimit)	14.409.996 24.016.660 x (1- 40%)
3.	Shpenzime tatim-taksa 1998-2001, 2003-2006	650.560
4.	Shpenzime tatim-taksa (2002)	110.000
5.	Shpenzime për sigurime shoqërore	334.560
6.	Shpenzime të tjera operative (energji, ujë, transport etj.)	150.000
7.	Shpenzime qiraje (përfshirë dhe tatimi i qirasë 10%)	672.000
8.	Të ardhura nga aktiviteti	7.689.544
9.	Të ardhura të tjera (paga ime si magjistrat dhe gjyqtar) Tetor 2003-Shtator 2005 paga 37,500 Lekë/muaj (magjistrat) Tetor 2005-Mars 2006 paga 64,000 lekë/muaj (gjyqtar)	1.246.500 (23 muaj x 37.500 - 862.500 leke) (6 muaj x 64.000 -384.000 leke)
10.	Shpenzime familjare	768.000
11.	Totali i të ardhurave të kursyera për periudhën në lekë	8.168.044
12.	Totali i të ardhurave të kursyera për periudhën, në euro*	66.031 Euro

45. Nisur nga fakti se nuk ka një dokument zyrtar që konfirmon marzhin e fitimit nga ushtrimi i aktivitetit tregtar të babit të subjektit për atë periudhë, trupi gjykues, pasi shqyrtoi edhe përgjigjet e marra nga organi kompetent tatimor, lidhur me marzhin e mundshëm të fitimit, nuk konstatoi elementë kundërshtimorë me shpjegimet e subjektit, dhe për rrjedhojë ka konkluduar se babai i subjektit të rivlerësimit ka patur mundësi financiare me burime të ligjshme për blerjen e apartamentit në shumën prej 49.000 euro në vitin 2006.

46. Me kontratën e kalimit të të drejtave me shpërblim nr. ***, datë 2.11.2012, subjekti i rivlerësimit së bashku me prindërit e tij në cilësinë e palës porositëse dhe kaluesit të drejtave reale, i kanë kaluar të gjithë të drejtat e tyre në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 27.1.2006, palës përfituese të së drejtave, z. E. Z. dhe znj. D. K., kundrejt shpërblimit. Ky kalim është miratuar dhe nga ana e shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e palës sipërmarrëse dhe pranuese të transferimit të drejtave reale.

47. Në datën 7.11.2012 me deklaratën noteriale nr. *** subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e tij deklarojnë se kanë marrë shumën 55.500 euro nga E. Z. dhe D. K. për shitjen e pasurisë së paluajtshme, apartament banimi, me sipërfaqe 79.9 m², nga e cila shumën prej 18.500 euro ose 1/3 e çmimit i përket subjektit të rivlerësimit.

48. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e interesave private të vitit 2012, përfitimin e shumës prej 18.500 euro. Sipas deklarimeve të subjektit kjo shumë është mbajtur në banesën e prindërve të tij, ku ka jetuar edhe vetë subjekti i rivlerësimit deri në momentin e blerjes së apartamentit. Kjo shumë ka shërbyer për pagesën në vlerën prej 11.461.65 euro, në vitin 2015, shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k.

49. Automjet, tip veturë, marka “Benz” me targa “****”, në bashkëpronësi me bashkëshorten. Blerë më datë 6.5.2014. Vlera është 6.000 euro. Zotëron 50%.

50. Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: Kursimet e bashkëshortes znj. N. R.

51. Nga analiza financiare rezulton se subjekti rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë patur të ardhura financiare për blerjen e këtij automjeti.

Hetimi i kryer nga Komisioni⁵

52. Më datë 10.9.2007, me kontratën nr. ***, subjekti i rivlerësimit ka blerë mjetin tip “Opel”, për shumën 200,000 lekë.

53. Më datë 30.12.2011 me kontratë shitje nr. ***, subjekti i rivlerësimit ka shitur mjetin tip “Opel”, për shumën 100,000 lekë.

54. Më datë 6.5.2014 me kontratën nr. ***, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka blerë mjetin tip “Daimler Chrysler”, për shumën 6.000 euro.

55. Nga analiza financiare rezulton se subjekti rivlerësimit ka patur të ardhura për blerjen e këtij automjeti.

Pasuritë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit

56. Automjet veturë tip “Peugoet 2006”, me targa ***, në bashkëpronësi me të atin, R. B., përfituar në muajin tetor 2010. Vlera është 4.000 euro. Zotëron 50%.

57. Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: Pagar nga kursimet personale dhe babait.

Hetimi i kryer nga Komisioni⁶

58. Me faturën tatimore nr. ***, datë 30.10.2010, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit së bashku me babain e saj kanë blerë mjetin tip “Peugeot” për shumën 250,996 lekë. Ka një mospërputhje midis çmimit të deklaruar dhe çmimit në faturën tatimore.

59. Në lidhje me këtë konstatim subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit sqaron se: *“Çmimi i deklaruar është ai real dhe Komisioni duhet të mbajë parasysh faktin se çmimi i deklaruar është më i lartë nga ai i faturës tatimore.”*

60. Shpenzimet e paraqitura në DPV përfshijnë ato të blerjes së automjetit si dhe taksat e paguara dhe shpenzime të kryera lidhur me mjetin tip “Peugeot”. Nga analiza financiare rezulton se znj. N. R. ka patur të ardhura për blerjen e këtij automjeti.

Në lidhje me pasuritë e babait të subjektit të rivlerësimit

Hetimi i kryer nga Komisioni⁷

⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 5.11.2018, drejtuar DPSHTRR-së. Kthim përgjigje DPSHTRR-ja nr. *** prot., datë 8.11.2018. Kthim Përgjigje DPSHTRR-ja nr. *** prot., datë 15.11.2018.

⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 5.11.2018 drejtuar DPSHTRR-së. Kthim përgjigje DPSHTRR-ja nr. *** prot., datë 8.11.2018; Kthim Përgjigje DPSHTRR-ja nr. *** prot., datë 15.11.2018.

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 05.11.2018 drejtuar QKB-së. Kthim përgjigje QKB-ja nr. *** prot., datë 20.11.2018. Shkresë nr. *** prot., datë 5.11.2018 drejtuar ZVRPP-ve. Kthim përgjigje ZVRPP-ja Tiranë, shkresa nr. *** prot., datë 19.11.2018; Shkresë nr. *** prot., datë 5.11.2018 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; Kthim përgjigje DPT-ja nr. *** prot., datë 12.11.2018; Shkresë nr. *** prot., datë 12.11.2018 drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat; Shkresë nr. *** prot., datë 12.11.2018 drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

61. Bazuar në shkresën e ZVRPP-së Tiranë rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit ka pasuritë e mëposhtme:

- a) Pasuria nr. ***, zona kadastrale ***, lloji i pasurisë truall, me sipërfaqe 251 m² në bashkëpronësi me 1/12 pjesë takuese. Në kartelën e pasurisë është vendosur shënimi “mbi këtë pasuri ka ndërtim pa leje”.

Trualli e ka origjinën nga dëshmia e trashëgimisë së nënës së babait të subjektit të rivlerësimit. Në lidhje me këtë konstatime subjekti i rivlerësimit sqaron se: *“Në këtë truall ka patur shtëpi ekzistuese të vjetër... Në atë shtëpi kanë banuar prindërit e gjyshes sime së bashku me të birin T. A. dhe familjen e tij. Me sa jam në dijeni shtëpia e vjetër është shembur dhe është ngritur një banesë e re pa leje e organit kompetent nga z. T. A. dhe të bijtë. Im atë nuk ka banuar asnjëherë në atë banesë dhe nuk ka lidhje me ndërtimin pa leje të kryer nga daja i tij dhe kushërinjtë.”*

- b) Pasuria nr. ***, zona kadastrale ***, lloji i pasurisë apartament, me sipërfaqe 53.8 m², në bashkëpronësi me 1/3 pjesë takuese.

Me kontratën e shitblerjes të vitit 1993, babai i subjektit të rivlerësimit së bashku me znj. M. R. e kanë blerë këtë apartament nga Ndërmarrja Komunale e Banesave për shumën 5,232 lekë. Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton në përbërjen familjare.

- c) Pasuria nr. ***, zona kadastrale ***, lloji i pasurisë apartament, me sipërfaqe 82 m², në bashkëpronësi me ½ pjesë takuese.

Babai i subjektit të rivlerësimit së bashku me znj. V. Zh., e cila është mamaja e subjektit të rivlerësimit, me kontratë shitblerje nr. *** datë 28.06.2000 kanë blerë apartament për shumën 2,000,000 lekë.

- d) Pasuri nr. *** lloji i pasurisë apartament me sipërfaqe 67 m² transkriptuar në favor të tretëve.

62. Me kontratën nr. ***, datë 6.8.2003, babai i subjektit të rivlerësimit së bashku me tre bashkëpronarët e tjerë i kanë shitur pjesën e tyre takuese z. Sh. R. për shumën 200,000 lekë. Pjesa takuese e babait të subjektit të rivlerësimit ka qenë 1/36.

63. Bazuar në të dhënat e administruar nga QKB-ja rezultoi se babai i subjektit të rivlerësimit figuron i regjistruar si person fizik me vendimin datë 13.11.1997 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, për të cilin nuk gjendet NIPT. Figuron i regjistruar si person fizik me NIPT ***, statusi aktual çregjistruar.

Në lidhje me të ardhurat e vjehrrit të subjektit të rivlerësimit

64. Bazuar në të dhënat e administruara nga QKB-ja rezulton se babai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit figuron ortak, zotërues i 1,754% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “****” sh.p.k., pajisur me NIPT ***. Figuron i regjistruar si person fizik me vendimin nr. ***, datë 2.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, për të cilin nuk gjendet NIPT.

65. Bazuar në shkresën e ZVRPP-së Berat nr. *** prot., datë 16.11.2018 rezulton se z. R. B. ka pasurinë nr. ***, zona kadastrale ***, me sipërfaqe truall 461 m² dhe ndërtim 139 m², përfituar me leje legalizimi.

66. Nga formulari i plotësuar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit më datë 17.1.2013 rezulton se ajo ka deklaruar si adresë në Tiranë, rrugën “****”, e cila është e njëjta adresë që deklaroi subjekti i rivlerësimit. Për sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit mund të ketë filluar bashkëjetesën me të që në vitin 2013 dhe kishte detyrimin ligjor për ta deklaruar.

67. Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit sqaron se: *“Gjatë kohës së fejesës, ime shoqe ka qëndruar efektivisht pranë prindërve të saj në Berat, ndërsa me*

gjendjen civile ka qenë e regjistruar në njësinë administrative nr. *** që nga koha që ndiqte studimet në Fakultetin e Drejtësisë Tiranë. Po kështu gjatë fejesës, ime shoqe ka qëndruar në fundjavë ose në data të caktuara në shtëpinë e prindërve të mi.”

68. Referuar të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit si dhe gjendjes së likuiditeteve në fund të vitit, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike vjetor dhe atë “Vetting” u konstatuan disa mospërputhje lidhur me gjendjen e likuiditeteve, për të cilat u pyet subjekti i rivlerësimit gjatë komunikimit elektronik.

69. Subjekti shpjegoi se në fund të çdo viti ka deklaruar gjendje të likuiditeteve dhe jo shtesat e tyre. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit u dukën bindëse dhe përshtateshin me deklaratimet dhe analizën financiare të kryer nga Komisioni.

70. Analiza financiare e subjektit të rivlerësimit rezultoi pa probleme.

Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
PASURI	0	0	467	16 897	226 713	13 671	18 435	-366	132 172	2 792 899	198 441	849 267	5 521 323	-1 007 021	8 762 898
Apartament Rr *** 79 m2															0
Automjet Opel Astra *** dt 10.03.2007					200 000				-200 000						0
Automjet Benz ***											840 660				840 660
Apartament Rr *** 110 m2													7 920 000		7 920 000
ndryshim likuiditete	0	0	467	16 897	26 713	13 671	18 435	-366	332 172	2 792 899	198 441	8 607	-2 398 677	-1 007 021	2 238
DETYRIME	0	0	0	0	158 327	-99 996	-58 331	0	0	0	0	0	6 392 000	-210 365	6 181 635
detyrim ndaj ndertuesit															0
Kredi Banka Popullore babai					158 327	-99 996	-58 331								0
Kredi BKT													6 336 000	-154 365	6 181 635
Kredi per blerje elektroshtepiake LUTE CREDIT Albania													56 000	-56 000	0
PASURI NETO	0	0	467	16 897	68 386	113 667	76 766	-366	132 172	2 792 899	198 441	849 267	-870 677	-796 656	2 581 263
Te ardhura nga paga SR dokumentuar	112 500	461 475	540 783	659 534	893 090	850 050	841 140	855 050	809 300	852 395	873 763	1 258 469	1 291 956	1 263 383	11 562 888
Te ardhura nga paga BSH dokumentuar	0											580 741	603 726	604 304	1 788 771
E ardhur nga shitja e shtepise										2 584 820					2 584 820
SHPENZIME	168 418	168 418	168 418	168 418	182 841	209 394	200 654	188 418	288 418	293 208	188 418	453 198	491 132	1 094 899	4 264 253
Interesa kredie					14 423	20 976	12 236								47 635
Humbje nga shitja e makines									100 000						100 000
Blerje elektroshtepiake sipas deklarimit tek detyrimet													112 000		112 000
Interesa kredie														249 085	249 085
Shpenzime jetese	168 418	168 418	168 418	168 418	168 418	188 418	188 418	188 418	188 418	188 418	188 418	369 132	379 132	379 132	3 099 995
Shpenzime udhetimi									104 790		0	84 066			33 818
Nderrhyrje mjeksore BSH Hygeia														432 864	432 864
Analiza dokumentuar		293 057	371 898	474 219	641 863	526 988	563 720	666 998	388 710	351 108	486 904	536 745	2 275 227	1 569 445	

Në lidhje me mbiemrin e nënës

71. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” ka deklaruar se nëna e tij ka mbiemrin R., ndërkohë nga i gjithë dokumentacioni i administruar ka rezultuar se ka mbiemrin Zh. Në lidhje me këtë fakt, subjekti i rivlerësimit sqaron se nëna e tij është divorcuar me babain e tij z. I. R. dhe ka mbajtur emrin e vajzërisë, Zh. Në vitin 1997 ka rifilluar bashkëjetesën me babain e tij dhe ka rilidhur martesë, duke mbajtur mbiemrin e vajzërisë.

72. Për sa më sipër subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë në plotësimin e deklaratës “Vetting” pasi ka deklaruar mbiemrin e nënës së tij R. dhe jo Zh.

73. Nga certifikata familjare rezulton se subjekti i rivlerësimit është larguar me martesë në njësinë nr. ***, datë 26.4.2006.

74. Është kryer një hetim në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të nënës së subjektit të rivlerësimit. Nga ana e ZVRPP-së Tiranë informohemi se ajo ka të regjistruara dy pasuri të paluajtshme: një pasuri të ndodhur në rrugën “****” për të cilën është folur më lart dhe një apartament në bashkëpronësi me sipërfaqe 52 m², ndodhur në rrugën “****”, përfituar nëpërmjet dëshmisë së trashëgimisë nr. ***, datë 19.10.2015, nga i ndjeri A. Zh.

75. Hetimi administrativ kryesisht, i kryer nga Komisioni, u shtri edhe më tej nga ai i deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit.

76. Për këtë është kërkuar informacion nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ALUIZNI, Qendra Kombëtare e Biznesit, Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Ujësjellës-Kanalizime Tiranë.

77. Nga hetimi nuk rezultoi nga ndonjë burim që ky subjekt të ketë pasuri të paluajtshme, të fshehura apo të padeklaruara, të mbajtura nga persona të tjerë.

78. Subjektit të rivlerësimit iu dërgua nëpërmjet adresës zyrtare të *e-mail*-it një pyetësor-tip dhe nga përgjigjet e këtij pyetësori, deklaratimet ishin korrekte dhe në përputhje me deklaratimet ndër vite të subjektit të rivlerësimit.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë

79. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, se ai ka kryer deklaratim të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezultojnë të jetë e ligjshme, nuk ka deklaratim të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

80. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2017 për subjektin e rivlerësimit, z. Eriol Roshi.

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

81. Si konkluzion, DSIK-ja ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit z. Eriol Roshi*.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

82. Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 18.6.2018.

83. Nga detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore rezultoi se subjekti i rivlerësimit Eriol Roshi ka deklaruar se në periudhën 7/10/2013 - 3.11.2013 ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, Dhoma Penale. Nga data 4.11.2013 e në vazhdim ushtron detyrën e kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në detyrën e gjyqtarit, subjekti deklaroi se ka qenë fusha e mosmarrëveshjeve administrative në kuptim të nenit 7 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar (këtu e në vijim ligji nr. 49/2012). Nuk ka deklaruar të ketë specializime në ndonjë fushë të së drejtës.

84. Në total, për periudhën e rivlerësimit 7/10/2013-7/10/2016 i janë caktuar 680 çështje, nga të cilat ka përfunduar 632 çështje. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se vitin e fundit të ushtrimit të detyrës 2016, ka mbartur 31 çështje.

85. Nga shqyrtimi i tre dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short ka rezultuar se:

- Subjekti i rivlerësimit ka aftësi të dukshme në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Tipar karakteristik i subjektit të rivlerësimit është kualifikimi i drejtë dhe në fillim të çdo vendimi gjyqësor i marrëdhënies juridike, objekt shqyrtimi gjyqësor, duke orientuar gjykimin dhe arsyetimin në këtë drejtim. Ai njeh dhe zbaton parimet procedurale gjatë gjyqimit. Analizon nga pikëpamja ligjore aktin administrativ dhe arsyeton rastin kur ai është absolutisht i pavlefshëm nëpërmjet argumenteve të saktë ligjorë. Ai përdor edhe ligjet e veçanta dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre. Tre dokumentet e përzgjedhura prej tij dhe 5 dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë në të drejtën administrative.

Subjekti i rivlerësimit kur është rasti për interpretimin e ligjit, referon në jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë. Në 1 rast është konstatuar se ai ka referuar edhe në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNj-së për procesin e rregullt ligjor.

Nga ana tjetër, ndër 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, janë ankimuar 6 prej tyre në gjykatat më të larta. Në 1 prej rasteve të ankimuara, Gjykata e Apelit nuk ka dhënë ende vendim, ndërsa në 5 rastet e tjera të ankimuara, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit. Në një prej këtyre 5 rasteve, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranim rekursi, ndërsa një rast tjetër ndodhet ende për gjykim pranë Gjykatës së Lartë. Në 2 raste vendimet janë të paankimueshme për shkak të ligjit.

- Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme. Ai respekton rregullat e drejtshkrimin dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar sipas një metodologjie të caktuar.

Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-SË

86. Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtari Eriol Roshi ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 30.6.2003 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2006. Pas studimeve, në datën 6.11.2006, ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Në vijim, në datën 4.11.2013 është emëruar gjyqtar dhe kryetar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku edhe vazhdon aktualisht.

87. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trivjeçare të rivlerësimit 8 tetor 2013- 8 tetor 2016, për gjyqtarin Eriol Roshi është paraqitur 1 ankesë (në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së. Kjo ankesë është arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor.

88. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Eriol Roshi përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

89. Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimi profesional. Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, rezulton se ai ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, respekton solemnitetin e gjykimit, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

Denoncimet nga publiku

90. Për këtë subjekt ka patur gjithsej 3 denoncime: nga shtetasit A. B, shtetasi F. Sh shtetasit I. I dhe A. I, për të cilat Komisioni nuk konstatoi indicie apo shkaqe të arsyeshme për fillimin e ndonjë hetimi.

91. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime lidhur me denoncimin e shtetasit A. B duke argumentuar se: *“Ka rezultuar nga aktet, si edhe arsyetoi në vendim se shtetasi në fjalë, palë në atë proces gjyqësor ka qenë prezent në shpalljen e vendimit. Ankimi i tij kundër vendimit nr. ***, datë 14.6.2017 është paraqitur në datë 23.6.2017.*

Në vendimin e datës 8.9.2017 nga ana ime është bërë llogaritja e thjeshtë e afatit 5-ditor , i cili ka nisur nga e nesërmja e shpalljes së vendimit, pra, data 15.6.2017, duke qenë se ankuesi ka qenë i pranishëm në shpallje, dhe afati 5- ditor përfundonte në datën 19.6.2017, e cila ka qenë ditë e hënë dhe ditë pune, ankimi i tij është konsideruar jashtë afatit dhe për këtë arsye i është kthyer.

*Nga verifikimet që kam kryer, pasi jam vënë në dijeni të emrit të ankuesit, më rezulton se edhe vendimi për kthimin e ankimit i është komunikuar shtetasit A. B nëpërmjet shërbimit postar me barkodin ***. Ai ka marrë dijeni në datën 15.9.2017 dhe nuk ka paraqitur sërish ankim gjyqësor brenda afatit 5- ditor, dhe për rrjedhojë vendimi ka marrë formë të prerë në datë 20.9.2017.”*

92. Në lidhje me ankimin e shtetasit F.Sh. subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se:

“Gjykimi i kësaj çështjeje është zhvilluar me trup gjykues me tre gjyqtarë, me kryesues gjyqtarin E. R., gjyqtaren G. M. dhe unë, kjo pasi objekt gjykimi ka qenë edhe “konstatimi i pavlefshmërisë së kontratave të kalimit të pronësisë së parcelave ndërtimore”, të cilat janë konsideruar nga praktika gjyqësore si kontrata administrative, dhe për rrjedhojë i janë nënshtruar gjykimit me trup gjykues, në bazë të nenit 12/1 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar.

*Me vendimin nr. ***, date 26.10.2018 është vendosur rrëzimi i kërkesë padisë në fjalë dhe sipas vërtetimit të kryesekretarisë së gjykatës këtu me nr. extra prot., datë 29.1.2019, të cilin e bashkëlidh, rezulton se dosja në fjalë është dërguar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 20.12.2018 dhe nuk është kthyer ende në ditën e lëshimit të vërtetimit nga ajo gjykatë.*

Në këtë kuptim, të gjitha pretendimet e mundshme të ankuesit në lidhje me gjykimin ku unë kam qenë anëtar, duhet dhe mund të zgjidhen nga një gjykatë më e lartë. Mund të them vetëm se si trup gjykues kemi zbatuar ligjin procedural; nga ana jonë janë pranuar të gjitha kërkesat e palës paditëse në lidhje me objektin e padisë, marrjen e provave të kërkuara nga ana e palës paditëse, përfshi edhe provën me ekspert nga fusha e topogjeodezisë (inxhinier ndërtimi më i njohur në këtë fushë). Në disa raste të mosparaqitjes së përfaqësueses së palës paditëse, i është dhënë mundësi palës, duke u shtyrë seanca për t’u paraqitur me përfaqësues.

Sa i takon vendimit përfundimtar, thelbi i arsyetimit për rrëzimin e padisë është se rrethanat e parashtruara nga pala paditëse sa i takon pavlefshmërisë së lejes së legalizimit, pra, mosekzistenca e objekteve informale në kohën e deklarimit, është shkak

për pavlefshmërinë relative dhe jo atë absolute si ka pretenduar pala paditëse dhe në këtë rast ajo do të ishte jashtë afatit të ngritjes së padisë.”

93. Për ankimin e ardhur nga shtetasit I. I dhe A. I, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Shorti gjyqësor ka përzgjedhur fillimisht gjyqtaren A. M., e cila më pas është larguar me leje të Presidentit të Republikës për periudhën shtator - tetor 2018, sipas shkresës nr. ***, datë 26.7.2018 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*

*Sipas urdhrit nr. ***, datë 3.9.2018 të kryetarit të Gjykatës, dosjet e saj janë rishortuar në datën 6.9.2018 dhe nga shorti i ri gjyqësor jam përzgjedhur unë si gjyqtar i çështjes.*

*Me vendimin nr. ***, datë 18.12.2018, kam vendosur rrëzimin e padisë së paditësve në fjalë për faktin e thjeshtë se ata nuk legjitimohen në ngritjen e padisë, pasi AMTP në favor të tyre rezultojnë të shfuqizuara. Duhet të kini parasysh se, sipërfaqja e tokës që rrjedh nga e aktet e marrjes së tokës në pronësi që u janë shfuqizuar paditësve, nuk kalojnë për llogari të privatit, por për llogari të shtetit shqiptar, kështu që përveçse interesit publik, nuk kam mbrojtur interes tjetër.*

Legjitimimi aktiv është kusht i domosdoshëm për t’iu drejtuar gjykatës, në kushtet kur paditësve u mungon ky element në ngritjen e padisë është çmuar rrëzimi i padisë.

Po kështu, rezulton se pala paditëse ka ushtruar ankim kundër këtij vendimi dhe pretendimet e saj do të rishqyrtohen nga një gjykatë më e lartë.”

94. Komisioni mori mediatikisht një denoncim nga emisioni “Boom” mbi shpërndarjen e ngarkesës për kryetarin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë z. Eriol Roshi, si dhe parregullsi në shortet e zhvilluara për vitin 2017.

95. Për këtë indicie të marrë mediatikisht u kërkua nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë dokumentacioni përkatës si dhe iu kërkuan shpjegime subjektit.

96. Subjekti i rivlerësimit paraqiti provat si dhe dha shpjegimet lidhur me këto informacione. Ai shpjegoi se: *“Në lidhje me këtë ankesë ose denoncim publik nëpërmjet këtij emisioni, më duhet të sqaroj paraprakisht Komisionin e nderuar se motivet e këtij emisioni dhe televizionit në fjalë nuk janë etike sa i takon denoncimit të tyre.*

*E them këtë, sepse në kohën e realizimit të këtij emisioni, shoqëria aksionare “****” e cila ka si aktivitet të saj pikërisht transmetimet televizive nëpërmjet TV “****” ku shfaqet edhe emisioni në fjalë, ka qenë duke zhvilluar një gjykim si palë paditëse, ku gjyqtar i çështjes kam qenë unë.”*

97. Z. Roshi në shpjegimet e tij përfundimtare ka sqaruar lidhur me procedurën e ndjekur për hedhjen e shortit si dhe detaje të tjera lidhur me çështjen objekt ankimi. Po ashtu nga verifikimi i dokumentacionit të ardhur nga gjykata, nuk rezultuan problematika të dukshme lidhur me këtë indicie të marrë mediatikisht.

98. Vlerësimi i përgjithshëm i kryer nga Komisioni mbi aftësitë profesionale menaxheriale të subjektit të rivlerësimit me cilësinë e kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, tregon se z. Eriol Roshi ka ndërmarrë disa iniciativa në 3 vitet e fundit për të përmirësuar funksionimin e kësaj gjykate. Shembuj të kësaj mund të gjenden në krijimin e një faqeje interneti (website), i cili përmirëson ndërveprimin me publikun dhe transparencën, mundëson aksesin në gjykatë të personave me aftësi ndryshe, krijon hapësira më të mëdha arkivimi, pagesën e borxheve “historike” të prapambetura që pengonin funksionimin e gjykatës etj.

99. Numri relativisht i kufizuar i rasteve të pazgjidhura, pa vendimmarrje, në pritje të gjykimit, në gjykatën e tij, së bashku me faktin se gjykata është në gjendje të vendosë për aq raste sa janë regjistruar rishtazi në një vit, është një shenjë pozitive.

KONKLZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatorit të çështjes, dhe pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, mbështetur në nenin 59 pika 1, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në provat që disponoi në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, konstaton se subjekti i rivlerësimit:

- a) ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b) ka arritur një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, dhe;
- c) ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Eriol Roshi.
2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 7.2.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta Tafa (Bungo)
Kryesuese

Valbona Sanxhaktari

Relatore

Lulzim Hamitaj

Anëtar

Sekretare gjyqësore
Fiorela Mandro